



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.140/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Demokracia Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.140/2025 datë 23.01.2025 e parashtruar nga subjekti politik Demokracia Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë përmes postës, nga subjekti politik Demokracia Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkelje të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Kodin e Sjelljes së Subjekteve Politike, neni 34, paragrafi 1.11, si dhe neni 35, paragrafi 2, për arsye se më 18 janar, në një takim në Gjilan, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti ka thënë " Ne jemi më të fortë dhe më të qëndrueshëm se Serbia, populli shqiptar është më i madh dhe më i lashtë", ku me këto fjali z.Kurti po krahasonte qartë popullin shqiptar dhe atë serb në tërësi, duke e vendosur popullin shqiptar në një pozitë superiore, më të vlefshme dhe më të vjetër se populli serb, duke nxitur kështu diskriminimin dhe urrejtjen ndaj popullit serb, i cili po ashtu jeton në Kosovë si popull i njohur me kushtetutë dhe si qytetarë të Kosovës. Një qëndrim i tillë nxit drejtpërsëdrejti dehumanizimin e popullit serb si më pak i vlefshëm, e për rrjedhojë edhe dhunën ndaj tij. Përveç kësaj, ajo gjithashtu shpie në frikësimin e serbëve të Kosovës.

Pala ankuese po ashtu thekson se me këtë fjali, z. Kurti në kontestin e shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në nenin 34 dhe 35, ka shkelur qartë Kushtetutën, si dhe nenet e lartpërmendura të Ligjit për Luftën kundër Diskriminimit, dhe posaçërisht nënvizojmë nenin 3

paragrafi 2, ku ai bëri një dallim dhe i dha përparësi epërsisë së popullit shqiptar në raport me atë serb, që do të thotë pa mëdyshje se ky lloj fjalimi përhap urrejtje dhe mund ta prodhojë efekti i zhvlerësimit ose rrezikimit të njohjes, gëzimit ose përmbushjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës Linkun e deklaratës, publikuar në faqen e Lëvizjes Vetëvendosje në Facebook: <https://www.facebook.com/share/v/1Aw7a8D5z/>.

Në përgjigje në ankesë të datës 24.01.2025 nga subjekti politik LVV, theksohet se meqë tubimi ka ndodhur me 18 janar 2025, dhe ankesa është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi me 23 janar, konsiderojmë që ankesa është e pasafatshme. Pra parashtruesi jashtë afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj një tubimi që ka ndodhur me 18 janar 2025, siç edhe paraqet në ankesë. Po ashtu në përgjigje theksohet se deklarata e tillë e bërë nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryetari i LV-së, Albin Kurti nuk cenon asnjë të drejtë për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes që janë pretenduar nga ankuesi siç janë neni 34.1.1 dhe bazat tjera të përmendura nga ankuesi.

Nga leximi dhe shqyrtimi i ankesës së parashtruar nga parashtruesi, konsiderojmë se: Ankesa është e pasafatshme, e palejuar dhe e pabazuar, dhe sa i përket bazave tjera ligjore të cilat ankuesi është mbështetur, i kundërshtojmë në tërësi, theksohet në përgjigje në ankesë, të subjektit politik LVV.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Demokracia Serbe, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: *përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesës, në ankesë e ka cituar fjalimin e Kryetarit të subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosjes Albin Kurti, ku sipas ankuesit, Kryetari i LVV-së, në tubimin e mbajtur në Gjilan, me datë 18 Janar, ndër të tjera ka deklaruar se “ *Ne jemi më të fortë dhe më të qëndrueshëm se Serbia, populli shqiptar është më i madh dhe më i lashtë*”, e që për Panelin nga këto deklarata në këtë fjalim nuk mund të merret se Kryetari i subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosjes Albin Kurti, ka shkelur nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, gjegjësisht ka përdorur gjuhë të urrejtjes ndaj ndonjë subjekti politik e në këtë rast ndaj subjektit politik Demokracia Serbe, pasi që në këtë fjalim Kryetari i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje Albin Kurti, i referohet vetëm Popullit Shqiptar, dhe Shtetit të Serbisë, mirëpo i njëjti nuk ka

përdorë gjuhë të urrejtjes ndaj ndonjë populli tjetër, e as ndaj ndonjë subjekti tjetër politik, i cili është i certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 140/2025 më datën 24.01.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.